



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 948/1 Prot.

Tiranë, më 14.08.2023

**V E N D I M**

**Nr. 163, Datë 14.08.2023**

Mbështetur në Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 143, datë 18.07.2023, e bërë nga T.Sh dhe L.Sh kundër Zyrës Vendore të Arsimit Bulqizë në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”<sup>1</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankimit dhe e-mail-in datë 24.07.2023, ankuesi në mes të tjerash informon se: “Ankesa kryesisht bazohet tek diskriminimi për shkaqe politike që i është bërë T.Sh dhe L.Sh, nga ana e Zyrës Vendore Arsimore Bulqizë. Pra, qëllimi kryesor është se dy anëtare të të njëjtës familje janë larguar nga puna në mënyrë joligjore, jo njerëzore, vetëm për shkak të bindjeve politike.

Në 2014-ën, një vit pasi ndryshoi qeverisja dhe Partia Socialiste erdhi në pushtet, T.Sh dhe L.Sh janë larguar nga puna (në datë 05.06.2014) nga ZVA Bulqizë në shkelje të ligjit (fakt që vërtetohet me Vendimin nr. 1031, datë 15.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për L.Sh dhe Vendimit nr. 55, datë 26.01.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për T.Sh).

<sup>1</sup> Referuar Vërtetimit nr. 05 dhe 06, datë 12.07.2023 të lëshuar nga Partia Demokratike, Dega Bulqizë, vërtetohet se T.Sh dhe L.Sh janë anëtare të PD-së dhe anëtare dhe vëzhguese në komisionet zgjedhore.

*Vendimet e Gjykatave ne i cilësojmë vetëm si shpërblim i dëmit administrativ që na u bë, dy mësuese anëtare të të njëjtës familje. Por për arsye të “luftës” politike, jemi goditur edhe moralisht, duke na shkaktuar stres dhe frikë, sepse ZVA Bulqizë arriti deri aty sa të përdor edhe policinë e shtetit vetëm e vetëm që ne të largoheshim nga puna. Prandaj kërkojmë që ankesa jonë të shqyrtohet në radhë të parë në këtë aspekt.*

*Ndërsa kërkesat për punë nga të dyja denoncueset, është bërë në mënyrë të vazhdueshme në Zyrën Arsimore Bulqizë, duke pasë kërkesa me shkrim dhe kontakte të drejtpërdrejta me drejtuesit e ZA Bulqizë çdo fillim viti dhe në vazhdim të vitit shkollor edhe në rastet kur kishte kërkesa për zëvendësues qoftë edhe të përkohshëm, për një periudhë të caktuar (barrëindje, raporte mjekësore, etj) por jo vetëm që nuk na ofrohej vend pune, por zëvendësimet bëheshin nga persona me arsim të mesëm, qoftë dhe joprofesional dhe që silleshin nga zonat e tjera me arsim më të ulët dhe në degët jopërkatese vetëm që ne të mos ktheheshim në punë, kjo ka vazhduar rregullisht gjatë gjithë periudhës që kemi jetuar në rrethin e Bulqizës, në periudhën kur kemi qenë banorë të asaj zone. Në një rast na është thënë që të regjistroheshim në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Pas regjistrimit, nuk kemi marrë asnjë përgjigje edhe pse jemi interesur pranë portalit. (Duhet theksuar se kërkesa për punë më shumë ka pasur nga ana e T.Sh, pasi L.Sh në 2016 u martua në Maqedoninë e Veriut).*

*T.Sh ka bërë kërkesa për punë edhe në vendbanimin e ri, që mbulohet nga Zyra Arsimore Durrës. Kërkesat kanë qenë si me takime me zyrtarët e institucionit, por edhe me letra, përgjigjja ka qenë që t’i drejtohem portalit. Edhe pse ka dërguar dokumentet e kërkuara në portal, sërish nuk ka pasur asnjë përgjigje as nga portali”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen dhe ka kërkuar nga subjekti ankues informacion dhe dokumentacion plotësues, lidhur me datat dhe procedurat e ndjekura për regjistrimin në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

- Për këtë arsye, me e-mail-in, datë 21.07.2023, inspektori i çështjes, ka kërkuar nga subjektet ankues që të paraqesë informacion dhe dokumentacion si më poshtë:
  - Periudhën kur janë regjistruar në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe kur kanë konkuruar për tu emëruar si mësuese dhe sa herë kanë konkuruar.
  - Datën kur kanë zhvilluar testin e informatizuar dhe renditjen në përfundim të konkurimit.
  - Komunikimin që kanë pasur me Komisionin e Vlerësimit.
  - Informacion nëse janë ankuar, për renditjen apo ndonjë proces tjetër.

Subjekti ankues, me e-mail-in datë 24.07.2023, dërgoi informacionin e sipërcituar në shpjegime.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në nenin 12, pika 1, germa c), të LMD, të ndryshuar, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: .....c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankueset pranë KMD-së, konstatohet se:

Së pari, lidhur me pretendimin e ankueseve për diskriminim nga ana e Zyrës Arsimore Bulqizë, sa i takon zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, Komisioneri vlerëson se:

- Nga verifikimet e kryera rezulton se pretendimet e parashtruara nga ankueset janë shqyrtuar nga KMD, në kuadër të dy ankesave të mëparshme, për të cilat Komisioneri është shprehur me dy vendimet respektive, si dhe nuk është depozituar asnjë provë apo fakt i ri për të filluar trajtimin e një çështjeje. Kështu:
  1. Nëpërmjet Vendimit nr. 162, datë 19.11.2015, Komisioneri ka vendosur mosdiskriminimin e T.Sh për shkak të bindjes politike dhe gjendjes familjare nga ana e Zyrës Arsimore Bulqizë, në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 10, datë 04.02.2015.
  2. Nëpërmjet Vendimit nr. 163, datë 19.11.2015, Komisioneri ka vendosur mosdiskriminimin e L.Sh për shkak të bindjes politike dhe gjendjes familjare nga ana e Zyrës Arsimore Bulqizë, në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 09, datë 04.02.2015.

Për sa më sipër, Komisioneri, mbështetur në nenin 33, pika 4/c e LMD, të ndryshuar, i cili përcakton se: *“Ankesa nuk pranohet nëse e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja”*, gjykon se pretendimet e ankueseve për diskriminim nga Zyra Arsimore Bulqizë, nuk mund të pranohen për shqyrtim.

Së dyti, referuar informacionit të cituar në ankesë dhe materialeve bashkëngjitur saj, rezulton që nuk është dërguar asnjë dokumentacion lidhur me procedurat e ndjekura nga ana e ankueseve për pranimin dhe emërimin e mësuesit, të cilat rregullohen sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021 të MAS *“Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”*”.

Për sa më sipër, referuar nenin 33, pika 4, germa “ç” të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ..... ç) ..... nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; ....., Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.*

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/c/ç, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

## **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës nr. 143, datë 18.07.2023, të paraqitur nga T.Sh dhe L.Sh kundër Zyrës Vendore Arsimore Bulqizë, pasi është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**